

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Operacionit Vivaldi", ofensiva që po i jep Ukrainës terren në Donetsk
ADRESA	https://piranjat.al/bota/operacionit-vivaldi-ofensiva-qe-po-i-jep-ukraines-terren-ne-donetsk-i106103
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 18:28:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 18:26:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f715d30a2e07806a48552c59076ad6c422ce4d1e7142f48fc65cca1341cf94e9
TEKSTI	cb38be743f6ab9c01339c1eba7d825b7721bd421792e3a42fcf3a35cb63c9aea
PAMJA	b01b87d8d091ccedb2091ee7507c5433dde9334cd658c1e4c7b42b5f289dc2e8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fa4f7ca3b1c8a822598675ef40b9ff3aaf0604b416bb7e5de188f900ea0317fd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9fd2d6c8eaed582dbfbd973ad421bf483fa1abd0a548cdf1a11aa95128494a7b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fa4f7ca3b1c8a822598675ef40b9ff3aaf0604b416bb7e5de188f900ea0317fd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [Kosovës, bashkuar, ku ishte e gjitha e](#) ■ ["ndaluar" për të rinjtë](#) ■ [së PD-së, ku ka folur për situa...](#) ■ [anetari i ri i KLGJ-së](#) ■ [së Lartë, për anëtar të Këshillit](#) ■ [te shenit te Komisaritatit të Krujës,](#) ■ [për të qytetin e Durrësit, ku shefi i](#) ■ [me emocionon dhe më](#) ■ [menyren si do ta ndërtojë skuadr...](#)

[BOTA](#)

“Operacionit Vivaldi”, ofensiva që po i jep Ukrainës terren në Donetsk

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 20:26



Ukraina pretendon se ka rimarrë së fundmi rreth 125 kilometra katrorë territor pranë qytetit Lyman, në rajonin lindor të Donetsk-ut, në kuadër të një operacioni të koduar “Vivaldi”.

Koloneli ukrainas Rodion Kudryashov, zëvendës komandant i Korpunit të Tretë të Ushtrisë, thotë se avancimi nuk nisi me lëvizjen e trupave në vijën e frontit, por shumë më herët, me ndryshimin e mënyrës së komandimit.

“Pasi u formua Korpusi i Tretë i Ushtrisë, ne ndryshuam sistemin e komandimit të njësisë në varësi të tij”, shkroi Kudryashov.

Sipas tij, disa brigada kishin mbërritur pas luftimeve të rënda, me humbje, mungesa në personel dhe, mbi të gjitha, me besimin te drejtuesit e tyre të dëmtuar.

Ndryshimi synonte largimin nga modeli më i ngurtë i trashëguar nga epoka sovjetike dhe kalimin drejt një strukture më fleksibël, ku vendimet merren më shpejt.

“Një ushtri ku çdo vendimi i duhen orë për të kaluar lart e poshtë në zinxhirin e komandës humbet përballë një ushtrie që të njëjtën rrugë e bën në minuta”, argumentoi Kudryashov.

Përpara se të avanconte, Korpusi i Tretë duhej të ndalte përparimin rus.

Forcat ruse po përdornin grupe të vogla për të depërtuar mes pozicioneve ukrainase, duke kërcënuar logjistikën dhe dobësuar gradualisht vijën mbrojtëse.

Deri në qershor, sipas Kudryashov, trupat ukrainase kishin stabilizuar frontin nga Borova në Lyman dhe kishin eliminuar zonat e infiltrimit rus.

“Faza e parë e ‘Vivaldit’ nuk ishte aspak një avancim. Ishte krijimi i kushteve që e bënë avancimin të mundur”, tha ai.

Më pas, njësitë ukrainase të sistemeve pa pilot nisën të godasin logjistikën ruse, përfshirë një tubacion dhe depo, duke detyruar forcat kundërshtarë të ndryshonin rrugët e furnizimit me karburant.

Operacioni përfshiu brigadat e korpunit, njësitë e zbulimit dhe dronëve, si dhe forca të operacioneve speciale, inteligjencës ushtarake dhe shërbimit kufitar.

Edhe kanali rus Rybar, i lidhur me Kremlinin, ka pranuar se Ukraina ka rifituar disa pozicione në këtë sektor gjatë kundërsulmeve të nisura në gusht, megjithëse ka paraqitur një vlerësim më të kufizuar të ndikimit të tyre mbi forcat ruse.

Kudryashov paralajmëron se rezultati mbetet i përkohshëm dhe se Rusia po përshtatet gjithashtu.

“Të fitosh një betejë nuk do të thotë ende të fitosh luftën”, tha ai. “Armiku po mëson gjithashtu. Ndryshon taktikat, kërkon pikat e dobëta dhe përpiqet të zgjerojë atë që funksionon.”

Artikuj te sugjeruar

BOTA 25 Shtator 19:51

[VIDEO/ Banditi grabit traktorin dhe pas arratisjes me shpejtësi shkatërron shtëpinë e rivalit](#)

Ky është momenti kur një bandit nxiton me shpejtësi në rrugë me një traktor të vjedhur, përpara se ta përplas&...

BOTA 25 Shtator 19:30

[Nga një milici lokale, në forcë të armatosur me raketa/ Pse huthit janë bërë kaq të rrezikshëm?](#)

Përballë Arabisë Saudite, që vetëm në vitin 2025 shpenzoi rreth 83 miliardë dollarë për mbrojtjen dhe zotëron ...

BOTA 25 Shtator18:35

[Parashikimi i tmerrshëm i Bill Gates: Inteligjenca artificiale mund të shkaktojë vdekjen e një miliard njerëzve](#)

Bill Gates bëri një deklaratë tronditëse, duke vlerësuar se inteligjenca artificiale mund të shkaktojë vdekjen e një mil...

BOTA 25 Shtator18:08

[Tensione në qiell/ Avionët e Suedisë dhe Finlandës "lojëra lufte" me avionët e Rusisë](#)

Forcat ajrore finlandeze thanë të premtën se avionë luftarakë suedezë dhe finlandezë ishin ngritur në ajër për të&eu...

BOTA 25 Shtator17:00

[Melania Trump kritikohet për paraqitjen e saj në takimin mes Xi Jinping dhe Donald Trump: Duket si kameriere! A nuk do të ishte një fustan më i përshtatshëm?](#)

Melania Trump u përball me kritika të shumta pas takimit të Donald Trump me presidentin kinez Xi Jinping të enjten në Shtëpinë...

BOTA 25 Shtator15:15

[“Raportet tona, kurrë më të mira”, Trump i dhuron Xi Jinping një shqiptonjë të SHBA-së](#)

Një banket madhështor u shtrua në Shtëpinë e Bardhë në nder të presidentit kinez Xi Jinping. Të dy liderët s...

BOTA 25 Shtator15:00

[Raporti i CIA-s për sulmet ruse, Macron: Nuk jemi informuar...](#)

Presidenti francez Emmanuel Macron ka mohuar raportimet se CIA kishte paralajmëruar Francën për një operacion të mundshëm rus me...

BOTA 25 Shtator14:46

[Inteligjenca Artificiale hyn në tregun imobiliar, shtëpitë nuk duken më si në realitet](#)

Fotot perfekte të shtëpive që dalin në shitje online nuk janë gjithmonë reale. Inteligjenca artificiale po përdoret gjithnjë...

BOTA 25 Shtator14:12

[Nju Jorku padit Polymarket, akuzohet për shkelje të ligjeve të lojërave të fatit](#)

Nju Jorku ka ngritur padi ndaj platformës së tregjeve të parashikimit Polymarket, duke e akuzuar për operimin e lojërave të fati...

BOTA 25 Shtator13:53

[Papa Leo XIV nis vizitën e parë zyrtare në Francë pas 18 vitesh](#)

Papa Leo XIV ka nisur vizitën e tij të parë zyrtare papnore në Francë, 18 vjet pas vizitës së fundit të këtij llo...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 25 Shtator

[“Më quajti lopë kur isha shtatzënë”/ Pas videos...](#)

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Kom...

AKTUALITET 24 Shtator

[Sherr mes Lalës dhe Rexhajt: Meriton të rrihesh...](#)

Një përplasje e ashpër ka ndodhur në studion e “Opinion” mes analistit Albatros Rexhaj dhe gazetares Klodiana Lala. Debati u nd...

AKTUALITET 24 Shtator

[Prova që fundosi shefin e Policisë Shkencore, d...](#)

Një akt-ekspertimi për makinën “Land Rover Defender”, i kryer me kërkesë të SPAK nga Policia Shkencore, ka mbërit...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSCLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro](#)

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1





PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit



Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.